



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
PA1 Nr.08 - 362
06.02.2025
Shkup

Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 2 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafi 10¹, dhe në lidhje me nenin 71 paragrafi (1) nënparagrafët 17 dhe 18 dhe neni 75 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e RM-së“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e RMV-së“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), neni 15 paragrafi (1) nënparagrafi 2, neni 39 paragrafi (1) nënparagrafi 10 dhe neni 51 paragrafi (1) të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.07.2019, pas zbatimit të Konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal, i shpallur në bazë të Vendimit të Agjencisë për shpalljen e konkursit publik, PA1 nr.08-275 datë 21.10.2024 („Gazeta Zyrtare e RMV-së“, nr.219/24 datë 29.10.2024), në pajtim me Raportin e vlerësimit të deklaratës së paraqitur PA1 nr.08-362 datë 03.02.2025 dhe Konkluzionin ark.nr.02- 531/3 datë 05.02.2025, në seancën e 4-ët mbajtur më 05.02.2025, miratoi si vijon:

VENDIM

**për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor,
në nivel lokal, në zonën e komunës së Kumanovës**

1. I NDAHET leja për transmetim në radio të shërbimit programor radio folëse-muzikore me format të përgjithshëm në të cilat llojet e programeve të përfaqësuara përmbushin së paku dy nga tre funksionet mediatike, në gjuhën maqedonase, në nivel lokal, në zonën e komunës së Kumanovës, të kandidatit, personit fizik Sasha Mitiq nga Kumanova, me adresë banimi në rr.„Denko Draganov“ nr.35, 1300 Kumanovë.

Shërbimi programor në radio nga paragrafi (1) i kësaj pike do të transmetohet nëpërmjet një radiofrekuence të përcaktuar nga Agjencia për Komunikime Elektronike të Republikës së Maqedonisë së Veriut (AKE), përkatësisht: 92.6 MHz.

2. Leja për transmetim në radio në nivel lokal, e përcaktuar në pikën 1. të këtij Vendimi, i ndahet për një afat kohor prej 9 (nëntë) vjetësh dhe nuk mund t'i transferohet një personi tjetër.

3. Pas pranimit të këtij Vendimi për dhënien e lejes, kandidati në konkurs, personi fizik Sasha Mitiq nga Kumanova, të cilit i është dhëna leja nga pika 1. të këtij Vendimi, duhet të regjistrohet si Shoqëri Tregtare Radiodifuzive në regjistrin përkatës, në pajtim me nenin 77 paragrafët (1) dhe (2) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV).

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive, e cila do të themelohet nga kandidati në konkurs, personi fizik Sasha Mitiq nga Kumanova, të cilit i është dhënë leja nga pika 1. të këtij Vendimi,

¹ Nënparagrafët 8 dhe 9 fshihen, shih: nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.248/18).

do të paguajë kompensim vjetor për lejen në llogarinë e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia), për çdo vit aktual duke filluar nga data e dhënies së lejes në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të faturës së dhënë (lëshuar) nga Agjencia. Mënyra e llogaritjes, faturimit dhe pagesës së kompensimit për lejen përcaktohet nga Agjencia në pajtim me nenin 80 të LSHMAAV dhe në pajtim me Rregulloren për procedurat e punës financiare dhe kontabël të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale („Gazeta Zyrtare e RM-së“, nr.185/14), Rregullores për formatet e shërbimeve programore të transmetuesve („Gazeta Zyrtare e RM-së“, nr.172/14) dhe Rregullores për zonat e transmetimit të programeve në televizion dhe radio („Gazeta Zyrtare e RM-së“, nr.172/14).

4. AKE, në bazë të lejes për transmetim në radio për përdorimin e radiofrekuencave, jep miratim për shfrytëzimin e radiofrekuencave në pajtim me Ligjin për Komunikime Elektronike.

Për përdorimin e radiofrekuencave, paguhet kompensim vjetor në llogari të AKE-së për çdo vit aktual paraprakisht duke filluar nga data e vlefshmërisë së miratimit për përdorimin e radiofrekuencave.

5. Shoqëria Tregtare Radiodifuzive, e cila do të themelohet nga kandidati në konkurs, personi fizik Sasha Mitiq nga Kumanova, të cilit i është dhënë leja nga pika 1. të këtij Vendimi, obligohet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë me datë 01.04.2025.

Në rast të mos respektimit të afatit për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë cekur në paragrafin (1) të kësaj pike të Vendimit, Agjencia do t’ia heq lejen e dhënë para skadimit të afatit për të cilën është dhënë leja dhe do ta fshijë transmetuesin nga regjistri i radiodifuzerëve.

6. Personi fizik, i cituar në pikën 1 të këtij Vendimi, të cilit i është dhënë leja për transmetim në radio është i detyruar të përmbushë plotësisht kushtet dhe kërkesat, për të cilat është angazhuar në Fletëparaqitje gjatë konkurrimit.

Agjencia do të kryejë mbikëqyrje profesionale në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga përfundimi i ditës së tridhjetë nga dita e fillimit të veprimtarisë së përcaktuar në lejen për transmetim në radio, për të përcaktuar plotësimin e kushteve teknike, në pajtim me fletëparaqitjen për dhënien e lejes për transmetim në radio.

7. Për këtë Vendim me shkrim do të njoftohet kandidati i Konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal, në zonën e komunës së Kumanovës, në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e miratimit të vendimit.

8. Ky Vendim është përfundimtar dhe publikohet në „Gazetën Zyrtare të RMV-së“ dhe në ueb-faqen e Agjencisë.

A r s y e t i m

Në pajtim me nenin 69 paragrafi (1) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV), për shërbimin programor radio tokësor të transmetuar përmes burimi të kufizuar siç janë radiofrekuencat, Agjencia e ndan lejen për transmetim në radio nëpërmjet konkursit publik.

Agjencia në pajtim me nenin 70 paragrafi (1) të LSHMAAV, miraton vendim për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio, sipas detyrës zyrtare ose pas pranimit të kërkesës me shkrim nga pala e interesuar, në pajtim me Planin për dhënien dhe shfrytëzimin e radiofrekuencave, si dhe në pajtim me Studimin e mënyrës dhe procedurës së përcaktuar në nenin 70 të Ligjit të lartpërmendur.

Këshilli i Agjencisë miratoi Vendim për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal, në zonën e komunës së Kumanovës, PA1 nr.08-275 datë 21.10.2024 („Gazeta Zyrtare e RMV-së“, nr.219/24 datë 29.10.2024), në bazë të Letrës për dhënien e lejes për transmetim në radio në nivel lokal, në zonën e komunës së Kumanovës nga i interesuari, personi fizik Sasha Mitiq nga Kumanova (nr ynë.ark.08-2944/1 datë 04.07.2024), Njoftimin e dorëzuar nga AKE në lidhje me kërkesën për informim për frekuencë të lirë për transmetimin e programit në radio në zonën e komunës së Kumanovës, ark.nr.0805-1989/2 datë 15.07.2024 (nr ynë.ark.08-2944/4 datë 17.07.2024), dhe në pajtim me Studimin e përgatitur për përcaktimin e arsyesimit për shpalljen e konkursit publik

për dhënien e lejes për radio në nivel lokal, në zonën e komunës së Kumanovës (ark.nr.03-4117/1 datë 04.10.2024).

Afati i fundit për dorëzimin e fletëparaqitjeve për pjesëmarrje në konkursin publik në fjalë ishte deri më 30.12.2024, përkatësisht nga kandidatët në konkurs është kërkuar që të paraqesin kërkesë në afat prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh, llogaritur nga dita e parë pas shpalljes së vendimit në „gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“. Përfundimisht deri me datë 30.12.2024 (afati i fundit për dorëzimin e fletëparaqitjeve), drejtuar Agjencisë është dorëzuar 1 (një) Kërkesë me dokumentacion shoqëruar për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal, në zonën e komunës së Kumanovës me datë 27.12.2024, nga kandidati, personi fizik Sasha Mitiq nga Kumanova (PA1 nr.08-362).

Hapja publike e Fletëparaqitjes së dorëzuar për pjesëmarrje në konkursin publik nga kandidati i lartpërmendur është mbajtur 1 (një) javë pas përfundimit të afatit për dorëzimin e fletëparaqitjeve, pra me datë 10.01.2025, ku fletëparaqitja e dorëzuar është shqyrtuar nga aspekti nëse ka qenë e rregullt, e dorëzuar me kohë dhe i kompletuar, respektivisht nëse i përmban të gjitha dokumentet e përcaktuara në nenin 73 paragrafi (3) të LSHMAAV, dhe që i referohen kandidati – personit fizik, për të cilin është mbajtur Procesverbali i hapjes publike (PA1 nr.08-362) datë 10.01.2025.

Në periudhën prej 10.01.2025 deri më 28.01.2025, Sektorët kompetent të Agjencisë kanë filluar vlerësimin e Fletëparaqitjes pas konkursit publik në fjalë (PA1 nr.08-362 datë 27.12.2024) të paraqitur nga kandidati, personi fizik Sasha Mitiq nga Kumanova. Fletëparaqitja e dorëzuar brenda afatit të caktuar është vlerësuar nga sektorët kompetent të Agjencisë, sipas kriterëve të vlerësimit të përcaktuara në tabelën në pikën 5 të Vendimit PA1 nr.08-275 datë 21.10.2024 për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal. Sektori për çështje programore vlerësoi kriteret nga pika 1, pika 2, pika 3, pika 4 dhe pika 7 e tabelës; Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit ka vlerësuar kriteret në pikën 5 të tabelës; Sektori për financa dhe logjistikë ka vlerësuar kriteret nga pika 9 e tabelës dhe Sektori i mbështetjes informatike dhe çështje të përgjithshme ka vlerësuar kriteret nga pika 6, pika 8 dhe pika 10 e tabelës.

Nga ku është konstatuar se Fletëparaqitja PA1 nr.08-362 datë 27.12.2024, nga kandidati, personi fizik Sasha Mitiq nga Kumanova është në rregull dhe është vlerësuar me pikë. Pra, Sektori për çështje programore (SÇP) në vlerësimin (kontributin) e dorëzuar më 20.01.2025 dhe më 23.01.2025, konstatoi se fletëparaqitja është e rregullt nga aspekti programor dhe vazhdoi me pikëzimin e mëtejshëm, përkatësisht në: pikën 1 të tabelës – Përfaqësimi në programin e prodhuar nga vetë transmetuesi (in-house production) gjatë javës, si arsytim për përmbushjen e kriterit është cekur se përfaqësimi i parashikuar i programit të prodhuar nga vetë transmetuesi është 100%, sa është dhe kohëzgjatja e pjesës folëse e programit (26 orë dhe 42 minuta); pika 2 e tabelës - Cilësia, zhanri dhe diversiteti tematik i përmbajtjeve, si arsytim për plotësimin e kriterit, thuhet se nga pjesa folëse e programit rezulton se do të përfaqësohen 12 (dymbëdhjetë) lloje programesh që përmbushin funksion edukativ, informues dhe argëtues; pika 3 e tabelës – Paraqitja e programeve që nxisin zhvillimin dhe ruajtjen e kulturës kombëtare, si arsytim për përmbushjen e kriterit thuhet se kandidati ka dëshmuar se gjatë vitit do të transmetojë 24 orë programre për ruajtjen e kulturës kombëtare, si dhe përfaqësimin e planifikuar të muzikës vokale dhe/ose vokalo-instrumentale në gjuhën maqedonase, instrumentale nga autorë maqedonas gjatë ditës është 30%; pika 4 e tabelës – Paraqitja e informacionit dhe e përmbajtjeve në pjesën folëse të programit me rëndësi për zonën në të cilën do të transmetohet shërbimi programor (informacion me karakter lokal), gjatë javës, si arsytim për plotësimin e kriterit, thuhet se paraqitja e informacionit dhe përmbajtjes me rëndësi për zonën në të cilën do të transmetohet shërbimi programor (informacion me karakter lokal), gjatë javës, në pjesën folëse të programit është 14 orë dhe në pikën 7 të tabelës – Koha e ofruar e programit të transmetuar gjatë ditës, si arsytim për plotësimin e kriterit thuhet se kandidati ka deklaruar se gjatë ditës planifikon të transmetojë program 24 orë në ditë. Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit (SPSDA) në kontributin e dorëzuar më 17.01.2025, ka konstatuar se Fletëparaqitja në fjalë është e plotësuar në mënyrë të rregullt, është e kompletuar (është dorëzuar deklaratë e noterizuar që kandidati nuk shkel dispozitat e Kreut IV të LSHMAAV), i përmbush kushtet minimale kadrovike të parashikuara në nenin 9 paragrafi (4) të Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për dhënien e lejes për transmetim televiziv dhe radio (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3953/1 datë 31.10.2023. Si arsytim për

plotësimin e kriterit në pikën 5 të tabelës, SMIPP ka konstatuar se në pajtim me Fletëparaqitjen, transmetuesi do të punësojë 2 (dy) persona në marëdhënie të rregullt pune dhe me orar të plotë dhe 2 (dy) persona honorar, që sipas Planit të Punës (në faqen 10) në marëdhënie të rregullt pune do të punësohen një redaktor përgjegjës në shërbimin programor dhe një gazetar dhe redaktor muzike, si dhe është kryer kontroll në Regjistrin Qendror të RMV-së (RQRMV) dhe është konstatuar se nuk ka pengesa ligjore për dhënien e lejes për transmetim në radio kandidatit në konkurs, personit Sasha Mitiq, dhe se është shënuar në pikën pikën 5 të tabelës – Numri dhe struktura e punonjësve që nevojiten për kryerjen e veprimtarisë (së paku 2 (dy) persona pjesëmarrës në krijimin e programit, të punësuar në marëdhënie të rregullt pune me orar të plotë). Sektori për financa dhe logjistikë (SFL) në kontributin e dorëzuar më 23.01.2025, konstatoi se dokumentet e paraqitura nga parashtuesi i Fletëparaqitjes në fjalë, nga aspekti financiar janë të kompletuara. Si arsyetim për plotësimin e kriterit në pikën 9 të tabelës, SFL është konstatuar se kandidati ka paraqitur një Plan Biznesi që përmban Planin financiar të planifikuar të radios për 5 (pesë) vitet e ardhshme, ku si garanci të ofruara për gjendjen financiare për kryer veprimtarinë, kandidati ka paraqitur dhe vërtetim nga një bankë komerciale – banka Kooperative Qendrore SH.A. Shkup, për depozitë në denarë në pronësi të parashtuesit të Fletëparaqitjes dhe Deklaratë nga personi Sasha Mitiq (e noterizuar), se mjetet financiare të ofruara paraqesin mjete që do shërbejnë për kryerjen e veprimtarisë në përputhje me konkursin publik në fjalë dhe kushtet e parashikuara në të, dhe është kryer pikëzimi i fletëparaqitjes në pikën 9 të tabelës – Garancitë e ofruara për gjendjen financiare për realizimin e veprimtarisë. Sektori i mbështetjes informative dhe çështje të përgjithëshme (SMIPP) në kontributin e dorëzuar më 15.01.2025 dhe më 28.01.2025, konstatoi se Fletëparaqitja në fjalë është e rregullt dhe vazhdoi me pikëzimin e tij, përkatësisht në: pikën 6 të tabelës – Kushtet teknike për prodhimin e programeve, si arsyetim për plotësimin e kriterit, SMIPP ka deklaruar se në Formularin nr.2 ku plotësohen kushtet teknike për prodhimin e programeve, kandidati i plotëson kushtet e kërkuara të Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për dhënien e lejes për transmetim televiziv dhe radio; pika 8 e tabelës – Kushtet hapësinore për kryerjen e veprimtarisë, si arsyetim për plotësimin e kriterit, SMIPP ka konstatuar se në të njëjtin Formular nr.2 ku janë paraqitur dhe kushtet hapësinore për kryerjen e veprimtarisë, kandidati i plotësoi kushtet e kërkuara në pajtim me Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për dhënien e lejes për transmetim televiziv dhe radio dhe në pikën 10 të tabelës – Afati i ofruar për fillimin e kryerjes së veprimtarisë, si arsyetim për plotësimin e kriterit, SMIPP ka konstatuar se kandidati në Fletëparaqitje si afat për fillimin me kryerje të veprimtarisë ka cekur datën 01.04.2025, që do të thotë deri në 3 (tre) muaj nga data e dhënis së lejes.

Në bazë të vlerësimit dhe limitit të pikëve(notimit) për plotësimin e Fletëparaqitjes për pjesëmarrje në konkursin publik të kandidatit, personit fizik Sasha Mitiq nga Kumanova, numri përgjithshëm i pikëve të fituara është 95 pikë, siç thuhet në Raportin e vlerësimit të fletëparaqitjes të përgatitur nga Agjencia PA1 nr.08-362 datë 03.02.2025, dhe është konstatuar se Fletëparaqitja PA1 nr.08-362 datë 27.12.2024, paraqitur nga kandidati i vetëm, personi fizik Sasha Mitiq nga Kumanova, i plotëson kushtet e përcaktuara në konkursin publik në pajtim me Vendimin e Agjencisë për shpalljen e konkursit publik, PA1 nr.08-275 datë 21.10.2024 („Gazeta Zyrtare e RMV-së“, nr.219/24 datë 29.10.2024).

Për të konstatuar saktë faktet gjatë marrjes së vendimit për dhënien e lejes për transmetim në radio, respektivisht për të përcaktuar se në cilat shoqëri tregtare paraqitet si themelues/pronar ose dhe drejtues personi fizik Sasha Mitiq nga Kumanova, më 15.01.2025, përmes Sistemit të shpërndarjes së internetit të Regjistrin Qendror të RMV-së, Agjencia ka ofruar „Informacion mbi subjektet e lidhura (personat e autorizuar, organe drejtuese, pronarë në subjekte të tjera – gjendjen vijuese“, nr.0820-50/150020250011412, nr.0820-50/150020250011427, nr.0820-50/150020250011433 dhe nr.0820-50/150020250011503 të gjitha nga data 15.01.2025, si dhe „Gjendja aktuale për personin fizik – pronar i vetëm“ nr.2007-50/150020250011448 datë 15.01.2025, ku është konstatuar se nuk janë shkelur dispozitat e Kreut IV të LSHMAAV.

Në lidhje me Raportin e vlerësimit të fletëparaqitjes së paraqitur për pjesëmarrje në konkursin publik për dhënien e lejes për transmetim në radio në nivel lokal PA1 nr.08-362 datë 03.02.2025, Drejtori i Agjencisë, drejtuar Këshillit të Agjencisë dorëzoi Propozimin PA1 nr.08-37 datë 04.02.2025, për marrjen e vendimit për dhënien e lejes për transmetim në radio të

shërbimit programor, në nivel lokal të kandidatit, personit fizik Sasha Mitiq nga Kumanova, me adresë banimi në rr.„Denko Draganov“ nr.35, 1300 Kumanovë.

Në bazë të gjithë kësaj që u theksua më lartë, Këshilli i Agjencisë në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 2 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafi 10, dhe në lidhje me nenin 71 paragrafi (1) nënparagrafët 17 dhe 18 dhe neni 75 të LSHMAAV, neni 15 paragrafi (1) nënparagrafi 2, neni 39 paragrafi (1) nënparagrafi 10 dhe neni 51 paragrafi (1) të Rregullores së Punës së Agjencisë (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.07.2019, pas realizimit të Konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal, i shpallur në bazë të Vendimit të Agjencisë për shpalljen e konkursit publik, PA1 nr.08-275 datë 21.10.2024 („Gazeta Zyrtare e RMV-së“, nr.219/24 datë 29.10.2024), në pajtim me Raportin e vlerësimit të fletëparaqitjes së dorëzuar PA1 nr.08-362 datë 03.02.2025 dhe Konkluzionin ark.nr.02-531/3 datë 05.02.2025, në seancën e 4-ët mbajtur më 05.02.2025, miratoi vendim si në dispozitiv, i cili është përfundimtar dhe pas miratimit të tij do të publikohet në „Gazetën Zyrtare të RMV-së“ dhe në ueb-faqen e Agjencisë.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale,
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Pjesëmarrësi në Konkursin për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal, shpallur në bazë të Vendimit PA1 nr.08-275 datë 21.10.2024 („Gazeta Zyrtare e RMV-së“, nr.219/24 datë 29.10.2024), nëse është i pakënaqur me Vendimin, ka të drejtë që në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Vendimit për paraqitjen e padisë në Gjykatën Administrative të RMV-së.